

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HËNË 30 MAJ 2022

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Zonja Kryetare e parlamentit,

Të nderuar qytetarë dhe qytetare shqiptare, që ndiqni këtë seancë me temë jashtëzakonisht të rëndësishme për një shoqëri të civilizuar: diskriminimin. Kur debatoni për këtë temë, mendja, para së gjithash, të shkon te minoritetet që jetojnë me shekuj në Shqipëri. E vërteta është se ata kanë qenë në këta 8 vjet qytetarët shqiptarë më të diskriminuar. Ata kanë qenë qytetarët më të diskriminuar të Europës dhe jo me ligje, por me praktika diskriminuese. Shkoni pak në zonat minoritare, kontrollonini pak cilat janë investimet e dërguara nga qeveria qendrore në këto zona! Zero.

Është ndjekur politika e shpërfilljes totale dhe e diskriminimit të tyre të plotë. Shkoni në Korçë! Edhe tregun ua morën. Shkoni kudo! Faktikisht, sot minoritetet në Shqipëri janë kryesisht fiktive, për të mos thëna të paqena, ndonëse jam i sigurt se për statistikë gjysma juaj janë të gatshëm të regjistrohen si minoritarë apo anëtarë të pakicave, paçka se ju jeni shkaku kryesor i kësaj drame të madhe. Kjo është situata me minoritetet. Por a është kjo situatë e shkëputur? Jo! Ky është regjimi i diskriminimit universal. Si askund në Europë, si në asnjë vend tjetër të lirë, këtu me ligje e vendime qeverie diskriminohen të varfrit; privohen nga shkollimi dhe arsimi.

A mund të imagjinoni ju që të ngrihet mesatarja për universitetet në nivelin e mesatares së Tiranës, në një kohë kur dy të tretat ose e tërë Shqipëria rurale është të paktën 1 pikë ose 1,5 pikë nën mesataren e Tiranës?! A mund të krahasohen? Pra, në këtë mënyrë ju i përjashtoni, i diskriminoni ata për faktin e vetëm se janë të varfër. Jeni kthyer në praktikën e etërve tuaj. Të diskriminuar janë demokratët. Me një të rënë të lapsit, u hoqën nga ndihma ekonomike 20 mijë familje në qarkun e Kukësit për faktin se nuk votojnë për qeverinë. Meqenëse jemi te Kukësi, po ju them se ai është qarku, i cili prodhon më shumë të ardhura për frymë për vendin se çdo qark tjetër: miliarda nga kaskada, qindra milionë nga Rruga e Kombit, qindra milionë të tjerë nga minierat.

A e dini ju se ai është sot qarku më i varfër në Europë dhe ka një diferencë, sipas statistikave tuaja, të të ardhurave për frymë prej 47% më pak se Tirana dhe 37% më pak se mesatarja kombëtare? Toka nuk ka

pasur diskriminues të tillë. Edhe Enver Hoxha përpiqej të bënte një lloj shpërndarjeje, kurse ju, duke praktikuar vjedhjen, diskriminoni të tërë Shqipërinë rurale. Para pak ditësh po kaloja në Pogradec. Një diskriminim ekstrem për qytetin, i cili nuk ishte kualifikuar për vjedhjen urbane, që ju e quani “Rilindje urbane”, por marrëzia juaj nuk kishte kufij, kur edhe Tushemishtin, një nga fshatrat perlë të Ballkanit, nuk e kishit përfshirë në 100 fshatrat e destinacioneve turistike.

Ju i diskriminoni dhunshëm komunitetet fetare, pronarët, të përndjekurit politikë. A e dini ju se në një kohë, kur burrat dhe gratë e këtyre zonjave dhe zotërinjve, që kam mbrapa marrin dhjetëra mijëra metra katrorë për të ndërtuar resorte turistike përrallore, gjatë 9 vjetëve pronarëve nuk u është kthyer asnjë metër katror pronë?! Përkundrazi, ligji është bërë pothuajse për t’i konfiskuar pronat e tyre dhe nga ato para, që i keni shpërndarë me sistemin e sekserëve, u merrni 30% për të bërë një kompensim financiar. Tokat e komuniteteve fetare grabiten dhe plaçkiten nga lukunia juaj në pushtet, që nuk njeh kufi në vjedhje. Ju u bëni ish-të përndjekurve politikë diskriminim klasor.

Me një akt të shëmtuar sot refuzuat Simon Mirakën, njërin prej ikonave të vuajtjes, të persekutimit, deshendent i një familjeje të shkëlqyer, të cilit, në kombinim me individë që i lidh krimi, i fshitë emrin për të shkuar Komisioner në Autoritetin e Dosjeve të Sigurimit të Shtetit. Diskriminimi juaj ndaj qytetarëve është i pakufishëm. A e dini ju sot, zonja dhe zotërinj, që 95% e proceseve gjyqësore fitohen vetëm nga narkoqeveria, qytetarët nuk i fitojnë më kurrë ato? Jashtë çdo imagjinate! Tani vendosët që me vendim ta shndërroni rekursin në një mekanizëm të vërtetë plaçkitjeje, të përzgjidhni ata, të cilët nuk do të shkojnë në Gjykatën e Lartë, natyrisht, kundrejt shumave të majme.

Pra, të dashur qytetarë dhe qytetare, me qeveritarë që vjedhin ditë e natë, që vjedhin kafshatën tuaj, ilaçet tuaja, që vjedhin ushqimet tuaja, që vjedhin çdo gjë, nuk mund të ketë asgjë tjetër, kurrë barazi. Barazia ligjore është thjesht një iluzion. Rruga e vetme është që secili prej nesh të mendojë për këtë vend që ta shndërrojme Shqipërinë në vendin e qytetarëve të lirë e të barabartë para ligjit. Faleminderit!